



Deri te
Kujdestarët ligjorë

Schaffhausen, 4. Shtator 2020

Stina e vjeshtës dhe dimrit – si të sillemi me ftohjet "e zakonshme" dhe me simptome tipike të koronavirusit

Të nderuar kujdestarë ligjorë

Kur afrohet stina e vjeshtës dhe dimrit ulen temperaturat, dhe shpeshtohen ftohjet tek fëmijët dhe të riturit. Gjatë kohës së koronavirusit dallimi në mes të një ftohje dhe një virusi nuk është aq i lehtë. Sipas departamentit të shëndetësisë duhet të ju përmbahemi hapave të veprimit si në vijim:

1. Fëmijët dhe të rinjtë me kollitje dhe teshtitje, e posaçërisht me temperatur (sipas normës: nga 38,3°C) duhet të qëndrojnë në shtëpi dhe guxojnë të shkojnë përsëri në shkollë, nëse kanë kaluar 24 orë pa ankesa.
Një teshtitje e thjeshtë nuk vlerësohet si ndezje akute e rrugëve të frymëmarrjes. E rëndësishme është, nëse shenjat gjegjësisht simptomet e smundjes, gjatë ditëve të ardhëshme keqësohen. Nga kjo rregull përjashtohen fëmijët që kanë Asthma apo teshtitje si pasojë e një alergjije. E cila gjë duhet të komunikohet dhe të vërtetohet me vërtetim mjekësorë nga Mjeku që i mjekon.
2. Nëse tek fëmijët ose të rinjtë paraqiten edhe ankesa të tjera, si dhimbje të fytyrës, gulçitja (frymëmarrje të shpeshtuar) me ose pa temperatur, ethe ose dhimbja e muskujve dhe/ose humbja e ndjenjes së nuhatjes dhe/ose shijes, atëherë duhet të qëndrojnë në izolim shtëpiak. Prindërit duhet të kontaktojnë Pediatrën ose mjekun shtëpiak, ose Corona-Hotline për të vendosur se si duhet vepruar më tutje. Sipas departamentit të shëndetësisë testet për koronavirus aktualisht nuk tregojnë rezultat tek fëmijët nën moshën 12 vjeçare..

Nxënësit dhe nxënëset, tek të cilët gjatë orës mësimore u paraqiten simptoma (**simptomat e një ftohje të zakonshme nuk bëjnë pjesë këtu!**) mësuesi do ti dërgojë në shtëpi (fëmijët deri në klasën e 2-të vetëm pas kontaktimit me prindërit) gjegjësisht duhet njëri nga prindërit

sa më shpejtë që është e mundur të vi e ta marrë nga shkolla (duke i shmatur transportet publike) dhe duhet që të lajmërohet pediatri ose Mjeku shtëpiak.

Ne jemi të vetëdishëm që pyetja e gripit nuk është e lehtë për t`u përgjigjur. Prindër të dashurë, prandaj jemi të varur veçanërisht nga ju. Vlerësojeni gjendje shëndetësore të fëmijut tuaj me sy kritik dhe vendosni, a duhet të shkoj në shkollë ose jo. Shkollat varen nga një bashkpunim i besueshëm me ju. Do të jetë e zakonshme që edhe fëmijët me ftohje të lehta të vijojnë mësimin. Një gjë e tillë duhet të jetë e mundshme pas vlersimit kritik të simptomave të përmendura më lart dhe me përmbajtjen e rregullave higjienike.

Për çdo pyetje keni në dispozicion Corona-Hotline-in të kantonit.

Tel.: +41 52 632 70 01; E-Mail: corona@sh.ch

Orari i punës: çdo ditë prej orës 08:00 deri 18:00

Informacione vazhdimisht të aktualizuara mund të gjeni në [Webseite des Gesundheitsamts](#) dhe tek [Webseite Coronavirus und Schule](#).

Ju lutemi që për të mirën e fëmive tuaj dhe gjithë shkollës t`iu përmbaheni rregullave të sjelljes. Ne ju faleminderojmë për bashkëpunimin tuaj dhe ju dëshirojmë juve dhe familjes suaj shëndet të mirë.

Me respekt

Departamenti i shkollës Primar-
dhe Sekundar I



Ruth Marxer, Direktorja